


TaxNews

August 2024
Gusht 2024



Deloitte.

Publikimi i udhëzimit të ri për kriteret dhe procedurat e zbatimit të marrëveshjeve tatimore

Ministri i Financave në datën 23 korrik 2024 nxori Udhëzimin nr. 11 "Për zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal" ("udhëzimi") i cili përcakton kriteret dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimit të evazionit fiskal të nënshkruara nga Shqipëria. Udhëzimi është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 133, datë 1 gusht 2024 dhe ka hyrë në fuqi që nga ajo datë, duke shfuqizuar udhëzimin Nr. 6, datë 10 shkurt 2004 "Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal" ("udhëzimi i mëparshëm").

Ky artikull ofron një përmbledhje të çështjeve kryesore të trajtuara në udhëzim.

Procedura e njoftimit dhe kërkesat për dokumentacion

Referuar udhëzimit, tatimpaguesit janë tërësisht përgjegjës për zbatimin e saktë të dispozitave të marrëveshjes. Autoritetet tatimore nuk do të japin më miratim për zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve siç parashikohej në udhëzimin e mëparshëm. Zbatimi saktë i marrëveshjeve do të vlerësohet nga strukturat e kontrollit tatimorë si pjesë e procedurave standarde të kontrollit.

Sipas udhëzimit, është e detyrueshme që tatimpaguesit shqiptarë të dorëzojnë njoftimin për zbatimin e dispozitave të marrëveshjes së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë autoriteteve tatimore nëpërmjet një portali elektronik i cili pritet të funksionojë brenda gjashtë muajve të parë të vitit 2025. Deri në funksionimin e portalit, njoftimi dhe dokumentacioni mund t'i dorëzohen autoriteteve

New instruction on criteria and procedures for application of tax treaties issued

The Minister of Finance on 23 July 2024 issued the Instruction No. 11 "On the implementation of agreements for the avoidance of double taxation and the prevention of fiscal evasion" ("the instruction") which defines the criteria and procedures for the application of the provisions of Albania's bilateral tax treaties. The instruction was published in Official Gazette No. 133, dated 1 August 2024, and entered into force as from that date, replacing the Instruction No. 6 of 10 February 2004 "On bilateral agreements for avoiding double taxation and preventing fiscal evasion" ("the previous instruction").

This article provides an overview of the key issues addressed in the instruction.

Notification procedure and documentation requirements

According to the instruction, taxpayers are wholly responsible for the accurate application of treaty provisions. The tax authorities will no longer provide approval for the implementation of the provisions as stipulated in the previous instruction. The correct application of treaties will be evaluated by tax inspectors as part of standard tax audit procedures.

Under the instruction, it is mandatory for the Albanian taxpayers to submit the notification for the application of the provisions of a treaty together with the supporting documents to the tax authorities via an electronic portal which is expected to be operative within the first six months of 2025. Until the portal is operational, the notification and the documents may be submitted to the tax authorities in hard copy or in an

tatimore në formë shkresore ose në format elektronik (p.sh., në një CD ose USB).

Në rast vështirësish teknike që pengojnë procesin e dorëzimit elektronik, tatimpaguesit mund të dorëzojnë njoftimin e zbatimit të marrëveshjes dhe dokumentacionin shoqërues me shkrim dhe me një mbajtës elektronik për ruajtjen e të dhënave. Dokumentacioni duhet të përfshijë:

- Formularin online (deklarata e digjitalizuar) në përputhje me modelin i cili gjendet në anekset e udhëzimit. Ky formular përfshin informacione që lidhen si me tatimpaguesin shqiptar dhe me tatimpaguesin e huaj rezident tatimor në shtetin tjetër kontraktues ("tatimpaguesi i huaj"), si dhe natyrën specifike të pagesës ose të ardhurave të përfshira. Formulari duhet të firmoset nga tatimpaguesi i huaj (përveç rasteve të veçanta) dhe tatimpaguesi shqiptar. Nënshkrimi i autoriteteve tatimore të juridiksionit të huaj nuk kërkohet.
- Kur është e aplikueshme, kontratat e shërbimeve të lidhura me tatimpaguesin e huaj, të paraqitura në gjuhën/gjuhët në të cilën janë nënshkruar nga palët. Aty ku kontratat janë komplekse, organet tatimore kanë të drejtë të kërkojnë përkthim në gjuhën shqipe. Në mungesë të një kontrate, tatimpaguesi duhet të japë detaje për llojin e shërbimeve të ofruara, kohëzgjatjen e shërbimeve, praninë fizike në Shqipëri dhe informacione të tjera.
- Certifikata e rezidencës tatimore e tatimpaguesit të huaj e përkthyer në gjuhën shqipe dhe në formatin e lëshuar nga autoriteti kompetent (letër ose elektronik) në shtetin tjetër kontraktues.

electronic format (e.g., on a CD or USB).

In the event of technical difficulties impeding the electronic submission process, taxpayers may file the treaty notification and accompanying documentation in writing, along with an electronic data storage device containing all of the required documentation. The submission must include:

- The online form (digital declaration) in accordance with the template annexed to the instruction. This form includes information relating to both the Albanian taxpayer and the foreign party to the transaction resident in the treaty partner jurisdiction ("foreign taxpayer"), as well as the specific nature of the payment or income involved. The form should be signed simultaneously by the foreign taxpayer (except for specific cases) and the Albanian taxpayer. The signature of the tax authorities of the foreign jurisdiction is no longer required.
- Where applicable, service contracts entered into with the foreign taxpayer, presented in the language(s) in which they were signed by the contracting parties. Where contracts are complex, the tax authorities have the right to request a translation into the Albanian language. In the absence of a formal contract, the taxpayer must provide details of the type of services provided, the duration of the services, physical presence in Albania, and other relevant information.
- The tax residence certificate of the foreign taxpayer translated into the Albanian language and in the format (hard copy or electronic) as issued by the competent authority in the treaty partner jurisdiction.

- Një listë analitike në formë tabelare të faturave (numri i faturës, data, përshkrimi, etj.) ose çdo dokumentacion tjetër që mbështet transaksionin.
- Informacion mbi pagesat e kryera nga tatimpaguesi rezident shqiptar ndaj tatimpaguesit të huaj, ose informacion mbi forma të tjera shlyerjeje ose kompensimi të rëna dakord midis palëve.

Sektori i marrëveshjeve tatimore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mund të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur nga tatimpaguesi në lidhje me zbatimin e marrëveshjes specifike dhe në rrethana të caktuara mund të kërkojë paraqitjen e dokumentacionit plotësues nga tatimpaguesi. Dokumentacioni shtesë duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej 45 ditësh kalendarike pas datës fillestare të paraqitjes së njoftimit të zbatimit të marrëveshjes nga tatimpaguesi.

Afati i paraqitjes së njoftimit

Njoftimi i marrëveshjes dhe dokumentacioni shoqërues duhet të dorëzohen brenda vitit kalendarik pas vitit në të cilin janë zbatuar dispozitat e marrëveshjes përkatëse. Mosdorëzimi i të gjithë dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati dënohet me gjobë prej 10 mijë lekësh për çdo muaj vonesë deri në 24 muaj pas përfundimit të afatit.

Një tatimpagues që nuk dorëzon dokumentacionin humbet të drejtën për të zbatuar dispozitat e marrëveshjes përkatëse dhe duhet të paguajë çdo tatim të papaguar, si dhe gjoba dhe interesa për pagesën e vonuar të tatimeve.

Konsiderata të tjera

- **Klasifikimi i riskut:** Struktura që mbulon marrëveshjet tatimore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

- A list of invoices (including invoice number, date, description, etc.) or any other documentation supporting the transaction.
- Information on the payments made by the Albanian resident taxpayer to the foreign taxpayer, or information on other forms of settlement or compensation agreed between the parties.

The tax treaty division of the General Tax Directorate may review the documents submitted by the taxpayer concerning the implementation of the specific treaty and in certain circumstances, may request the submission of supplementary documents from the taxpayer. These additional documents must be provided within a period of 45 calendar days following the initial date of submission of the treaty notification by the taxpayer.

Notification submission deadline

The treaty notification and supporting documents must be submitted within the calendar year following the year in which the provisions of the relevant treaty were applied. Failure to submit all the required documentation within this deadline is subject to a penalty amounting to ALL 10,000 for each month of delay for up to 24 months following the deadline.

A taxpayer that fails to submit the documents loses the right to apply the provisions of the relevant treaty and must pay any unpaid taxes, as well as penalties and interest for late payment of taxes.

Other considerations

- **Risk classification:** The tax treaty division of the General Tax Directorate (GTD) categorizes treaty

(DPT) i kategorizon njoftimet për zbatimin e marrëveshjeve si me risk të ulët ose të lartë bazuar në kritere specifike. Për rastet e klasifikuara si me risk të lartë, struktura që mbulon marrëveshjet tatimore në DPT, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të dokumentacionit, njofton drejtorinë rajonale tatimore për gjetjet dhe jep udhëzime për kontrollin tatimor që duhet të ushtrohet.

- **Kontrollet tatimore:** Kontrollet tatimore në lidhje me zbatimin e dispozitave të një marrëveshje integrohen brenda programeve të kontrollit tatimor të përgjithshëm. Në rastet e identifikuara si me risk të lartë, autoritetet tatimore mund të kryejnë kontrolle tatimore me qëllimin e vetëm të kontrollit të zbatimit të drejtë të marrëveshjes.
- **Referenca ndaj komentareve:** Për qëllime të interpretimit të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë, tatimpaguesit mund të konsultohen me komentarët e marrëveshjeve model të publikuar nga Organizata për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim (OECD), si dhe nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB).
- **Kërkesa për interpretim:** Tatimpaguesit mund të paraqesin një kërkesë për interpretim në sektorin e marrëveshjeve tatimore të DPT-së, duke kërkuar një interpretim zyrtar të marrëveshjes përkatëse. DPT duhet të japë një përgjigje me shkrim për kërkesën brenda 45 ditëve.

notifications as low- or high-risk based on specific criteria. For cases classified as high-risk, the tax treaty division of the GTD, within 30 days from the date of filing the documents, notifies the regional tax directorate of the findings and provides guidance on any tax audit required.

- **Tax audits:** Tax audits conducted in relation to the application of the provisions of a treaty are integrated within the overarching framework of general tax audit programs. In cases identified as high-risk, the tax authorities may conduct tax audits for the sole purpose of auditing the correct implementation of the treaty.
- **Reference to commentaries:** For the purpose of treaty interpretation, taxpayers may consult the official commentary to the model treaties published by the Organization for Economic Co-operation and Development (OECD) or the United Nations (UN).
- **Ruling request:** Taxpayers may submit a ruling request to the tax treaty division of the GTD, seeking an official interpretation of the relevant treaty. The GTD must provide a written response to the ruling request within 45 days.

Related Contacts

Blerina Memo

Tax Partner | Tax & Legal
Deloitte Albania sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
E-mail: bmemo@deloittece.com

Gledia Kokoshi

Tax Senior Manager | Tax & Legal
Deloitte Albania sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
E-mail: gkokoshi@deloittece.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the “Deloitte Network”) are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.